


# GreenAL

Tryezë e Rrumbullakët  
Rajoni Qendror

12 Qershor, Tiranë

# Çfarë synon GreenAL ?



**GreenAL** synon të fuqizojë OSHC-të mjedisore shqiptare për të marrë pjesë dhe kontribuar në mënyrë efektive dhe direkte në procesin e negociatave për anëtarimin në BE, si dhe të kontribuojë në mënyrë proaktive në adresimin e sfidave mjedisore, nëpërmjet advokimit, ndikimit në politika dhe monitorimit nga niveli lokal në atë kombëtar.



# Objektivat kryesor



- 1. Të mbështesë dhe fuqizojë më tej OSHC-të mjedisore në Shqipëri** duke forcuar kapacitetet e tyre për të trajtuar në mënyrë proaktive çështjet mjedisore dhe konsoliduar legjitimitetin e tyre për të përfaqësuar më mirë kauzën e tyre dhe/ose komunitetet e prekura.
- 2. Të stimulojë dhe inkurajojë përfshirjen aktive të OSHC-ve mjedisore** në proceset e vazhdueshme dhe të ardhshme që lidhen me Acquis dhe tranzicionin e gjelbër në nivel lokal, rajonal, kombëtar.
- 3. Të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetve dhe llogaridhënies së vendimmarrësve** mbi sfidat e ndryshimeve klimatike, ndotjes dhe mbrojtjes së natyrës nëpërmjet advokimit, ndikimit në politikbërje dhe monitorimit.



# Shtrirja territoriale



- Mbështetja e OSHC-ve mjedisore për të konsoliduar pozicionin e tyre në bashkinë/rajonin përkatës;
- Rritja e sinergjive ndërmjet OSHC-ve, ekspertëve, aktivistëve, bizneseve dhe institucioneve publike;
- Rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe grupeve të interes për çështjet mjedisore.



# OSHC-të dhe roli i tyre në proceset politikbërëse



## Udhërrëfyes për politikën e qeverisë drejt një mjedisi më mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile - 2018-2022

### Drejtimi Strategjik 1: Bashkëpunimi i institucionalizuar qeveri-shoqëri civile në politikëbërje dhe në integrimin evropian

- **Prioriteti 3:** Përfshirja e qendrueshme dhe efikase e OShC-ve në procesin e politikëbërjes dhe në integrimin evropian (5 masa, 14 tregues).

Kryesisht i fokusuar tek procesi i konsultimit publik, zhvillimi i tyre real dhe adresimi i çështjeve të ngritura, monitorimi i kryerjes së konsultimeve dhe marrjes në konsideratë të sugjerimeve.

- **Prioriteti 4:** Garantimi i kontributit të OShC-ve në procesin e anëtarësimit në BE në përputhje me praktikën e mira të BE-së (7 masa, 21 tregues).



# Grupet e Interesit



- Organizatat e shoqërisë civile me fokus ato mjedisore;
- Komunitetet, të rinjtë e të rejtat, qytetarët;
- Aktivistë dhe ekspertë mjedisor;
- Universitetet, institucione akademike, studentët;
- Media;
- Institucione lokale, rajonale dhe kombëtare (Bashkitë, Këshillat Bashkiak, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), dhe Agjencitë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (ARZM)).



# Mjedisi dhe prioritetet në EU/BP



Ballkani Perëndimor është një nga rajonet në Evropë më të prekura nga ndikimi i ndryshimeve klimatike dhe ky trend parashikohet të vazhdojë.


**Rajoni vlerësohet i cenueshëm** kryesisht nga **mungesa e ujit, thatësitrat, rritja e temperaturave, rritja e nivelit të deteve, erozioni bregdetar, përmbytjet, zjarret** të cilat me gjasë do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik e social të vendeve mesdhetare.

Referuar Indeksit Botëror të Riskut (World Risk Index 2023), Shqipëria ka një indeks risku “të lartë”- dhe renditet e 6-ta në Evropë dhe e 76-ta nga 193 vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara.


Axhenda e Gjelbër për BP: (1) dekarbonizimi, energjia dhe lëvizshmëria, (2) ekonomia qarkulluese, mbetjet, riciklimin, përdorimin efikas të burimeve, (3) biodiversitetin, (4) ndotja e ajrit, ujit dhe tokës dhe (5) sistemeve të qëndrueshme ushqimore dhe rurale



# Mjedisi dhe prioritetet në EU/BP



## Statusi mbi cilësinë e ajrit në Evropë 2024 – Agjencia Evropiane e Mjedisit





# Mjedisi/prioritetet/OSHC-të



## Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim European 2030


**Vizioni:** *Mbështetja dhe inkurajimi i OJF shqiptare për një përfaqësim sa më të qenësishëm dhe aktiv të interesave të qytetarëve dhe një kontribut praktik në reformat e ndërmarra dhe në politikat zhvillimore dhe të integritit në BE, në nivel komuniteti, lokal, kombëtar, rajonal dhe në politikat e BE-së që ofrojnë mundësi të për një qasje të tillë.*

### Objektiv strategjik


SKZHI 2030 synon rritjen e reziliencës, rëndësisë, legjitimitetit dhe impaktit të aktorëve të sektorit të OJF në Shqipëri si: **i) përfaqësues të interesave të grupeve qytetare; ii) mbajtës të njohurive kritike të domosdoshme për suksesin dhe qëndrueshmërinë e reformave, politikave sektoriale dhe progresit të vendit drejt BE-së; dhe, iii) partnerë të institucioneve dhe faktorë në suksesin e reformave, të zhvillimit të vendit dhe progresit të vendit drejt BE-së.**




# SKZHI për zonat e mbrojtura



Zonat e Mbrojtura kanë rëndësi të madhe ekologjike për vendin. Këto zona janë nën kërcënim në rritje për shkak të migrimit të popullsisë, **kërkesës në rritje për industrializim**, shoqëruar me rritjen e ndotjes, copëtimin e habitatit, pakësimin e biodiversitetit dhe shkatërrimin e përgjithshëm mjedisor.



# Temat kryesore të GreenAL




**Ndryshimet Klimatike:** Efienca e Energjisë, Burimet e Rinovueshme, Varfëria Energjitike, Dekarbonizimi, Lëvizshmëria/transporti, Bujqësia, Nxehësia Urbane, Uji dhe Ekonomia Qarkulluese;

**Ndotja:** Ajri, Uji, Toka, Zhurma, Mbetjet, Shkarkimet;

**Natyra:** Zonat e Mbrojtura, Habitatet, Shërbimet e Ekosistemit, Natyra 2000, Pyllëzimi, Mbrojtja dhe Ruajtja.



# Mbështetja financiare OSHC mjedisore



**Grante Tematike** - mbështetje për OSHC-të që kanë në fokus dhe zotërojnë ekspertizë në një nga tre temat kryesore (Klima, Natyra, Ndotja);

**Mbështetja financiare për grant:** 60,000 Euro


**Kohëzgjatja:** 24 -30 muaj;

**Fokusi:** Advokim, ndikim në politikbërje, mentorim, dialog në nivel kombëtar;

**Partneriteti:** i detyruar me institucione në nivel kombëtar/ lokal/, institucione akademike dhe kerkimore;

**Projekte të financuara:** 3 për një total prej 180,000 Euro.

# Mbështetja financiare OSHC mjedisore



**Grante Rajonale** - kanë në fokus OSHC të cilat duan të krijojnë rrjete rajonale për të marrë veprime konkrete në adresimin e problematikave mjedisore në bashkëpunim me institucionet vendore e rajonale. Organizata lider duhet të tregoj lidhje të forta me temën dhe territorin.

**Mbështetja financiare për grant:** 50,000 Euro me mundësi investimi deri në 25%


**Kohëzgjatja:** 18 - 24 muaj;

**Partneriteti:** ndërmjet OSHC-ve dhe autoritete lokale/ rajonale;

**Projekte të financuara:** deri në 12 për një total prej 600,000 Euro.



# Mbështetja financiare OSHC mjedisore



**Grante të iniciativës** - kanë në fokus OSHC të cilat duan të evidentojnë problematika mjedisore të cilat prekin komunitetet lokale;

**Mbështetja financiare për grant:** 17,000 Euro;

**Kohëzgjatja:** 12 - 18 muaj;

**Partneriteti:** Nuk e kanë të detyrueshme por mund të bashkëpunojnë me një nga grupet e interest të GreenAL;

**Projekte të financuara:** deri në 20 për një total prej 340,000 Euro.



# Mbështetja financiare OSHC mjedisore



**Grante të Dedikuara/On the Spot Grants**, konsistojnë në mbështetje financiare për OSHC që adresojnë një kauzë në zhvillim apo çështje emergjente mjedisore.

**Mbështetja financiare për grant:** 5,000 Euro;

**Kohëzgjatja:** 3 - 6 muaj;

**Partneriteti:** Nuk e kanë të detyrueshme por mund të bashkëpunojnë me një nga grupet e interest të GreenAL;

**Projekte të financuara:** deri në 7 për një total prej 35,000 Euro.



# Ndarja në kohë e granteve



Shtator - Tetor  
2024

Nëntor -  
Dhjetor 2024

Maj 2026

Nëntor 2026

Maj 2027



Maj - Qershor  
2025

Qershor –  
Korrik 2025

Korrik 2026

Janar 2027

Korrik 2027





# Mbështetja tematike



## Infosessions

- Dy (2) sesione të dedikuara për thirrjen e parë (**grantet tematike dhe rajonale**)
- Katër (4) sesione të dedikuara për thirrjen e dytë (**grantet rajonale dhe të initiatives**)

## Trajnime

- Çështje administrative, financiare dhe të komunikimit;
- Inkubime tematike mbi çështjet urgjente mjedisore, integrimin në BE, Green Agenda, etj.

## Çështjet gjinore

- Trajnim dhe mentorim për faktorizimin e implikimeve gjinore dhe socio-ekonomike tek OSHC-të

# GreenAL

## Perspektiva Gjimore në Projektet Mjedisore

## Ndryshimi i klimës/degradimi i mjedisit VS Gratë

Gratë ndikohen ndryshe nga burrat për shkak të barrierave socio-ekonomike, politike dhe ligjore që limiton zgjedhjet e tyre. Barrierat përfshijnë:



Akses i limituar në burime financiare dhe shpesh paga më të ulta

Ligje diskriminuese që limitojnë pjesëmarrjen e grave në forcën punëtore.

Mungesa e fuqisë vendimmarrëse në familje, dhe nivel vendorë, kombëtar dhe ndërkombëtar.

2.5 herë më shumë punë e papaguar dhe përkujdesëse sesa burrat.

Kufizime në pronësinë e tokës.

Mungesë teknologjie dhe burime për rritje kapacitësh.



# Perspektiva Gjinore



Vlerëson përfshirjen e grave dhe burrave në projekte dhe bën nevojat, shqetësimet dhe eksperiencat e grave dhe burrave pjesë e hartimit, implementimit, monitorimit dhe vlerësimit të projekteve në sferën politike, ekonomike, sociale dhe mjedisore, kështu gartë dhe burrat përfitojnë njëllëj.

## Analiza gjinore, thekson diferencat:

- ndërmjet dhe midis grave dhe burrave;
- shpërndarjen e burimeve;
- mundësive;
- kufizimeve dhe pushtetit në një kontekst të caktuar;



## Analiza e situatës, elementet që mund të merrni në konsiderat:

- **Analizë e politikave dhe kuadërit ligjore:** A ka legjislacion I cili promovon barazinë gjinore në tërësi dhe në fushën e mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. A ka ndonjë barrier ligjore për punësimin e grave apo grupeve të tjera vulnerable, cilat janë të drejtat e pronësisë për burrat dhe gratë, pronësia është në emërin e kujt.
- **Analizoni rolet gjinore/përgjegjësit, koha e përdorur** (ndarja e punës midis burave dhe grave): Niveli I pjesëmarrjes në tregun e punës, ekonomia formale dhe informale, cila përqindje e burrave dhe grave janë të punësuar në p.sh: energjistik, bujqesi, peshkim, etj. A ka punë/role të cilat cilësohen si të përshtatshme për burrat dhe jo për gratë. Kush do punësohet nga një projekt I ri (në fushën energjitike, bujqësi, peshkim, infrastrukturë) etj.
- **Kush ka akses dhe kontroll mbi burimet ( të ardhura, tokë, kohë, pajisje, njohuri):** Kush e posedon token dhe kush e përdorë. A ka norma/ barriera për gratë që të përfshihen dhe përfitojnë nga një sferë e caktuar. A kanë burrat dhe gratë akses në edukim, shërbime shëndetësore, a mund të marrin kredi?
- **Analizë të strukturave institucionale (Vendim-marrja):** Cila është përqindja e burrave dhe grave në pozicione vendimarrëse në fushën e mjedisit në nivel ministrish, drejtorish, institute, bashki e tjerë.




## Qasjet e integritit të perspektivës gjinore në projekt:




- Integrim i barazisë gjinore;
- Aktivitete gjinore të targetuara;
- Ndërgjegjësim gjinorë;



# Rrjetëzimi



Rrjetëzimi është **shkëmbimi i informacionit dhe ideve** midis **njerëzve** me një profesion të përbashkët ose interes të veçantë, zakonisht në një mjedis shoqëror joformal. **Rrjetëzimi shpesh fillon me një pikë të vetme të përbashkët.**





# Rrjetëzimi

Rrjetëzimi ka një **efekt amplifikues**. Amplifikim në këtë kontekst do të thotë që efekti i problematikës së ngritur nga një grup njërëzish, organizatash është më i lartë sesa një problematikë e gritur disa herë nga një individ apo organizatë.



Rrjetëzimi është një mjet për të siguruar një **bashkëpunim** më të madh **kombëtar, rajonal ose ndërkombëtar** i cili mund të forcojë ndikimin e aktiviteteve të kryera nga organizatat me bazë komunitare.





# Lloji i rrjetit



## Rrjeti formal

Krijohen nga individë, institutute apo organizata të pavaruara të krijuara për të **adresuar një ose disa problematika** në varësi të qëllimit të tyre.

Anëtarët kryejnë një sërë aktivitete të dakordësuara dhe takohen rregullisht me njëri tjetrin. Në përgjithësi rrjetet formale kanë një **rregullore/statut** i cili paraqet qëllimin dhe detyrimin e anëtarëve.

Rrjetet formale mund të kenë në përbërjen e tyre OSHC, institucione qeveritare, agjenci zhvillimi dhe palë të tjera interesi në nivel rajonal apo ndërkombëtar.



# Rrjetëzimi



Faza e parë e GreenAL mbështeti financiarisht **më shume se 50 organizata** dhe ngriti **një rrjet prej 80 organizatash**, ekspertësh, universitetesh etj.

Në këtë fazë do të synojmë të **formalizojmë** këtë rrjet organizatash nëpërmjet një Memorandumi Bashkëpunimi.



+40 trajnime



**943 pjesëmarrës**



56% ose 519 pjesëmarrëse femra



**+150 OShC pjesëmarrëse në takime dhe forume**



+30 institucione publike



40 ekspertë të pavarur



**+60 OShC kanë firmosur deklaratat mjedisore**


# Monitorimi



Në vazhdim të punës së bërë me projektin 'Mushkri të gjelbërta' dhe monitorimeve të kryera në GreenAL ky proces do të vijojë edhe për vitet e ardhshme.

Do të monitorohet ndotja e:




- Ajrit;
- Zhurmat;
- Ujit;
- Tokës.




# Monitorimi




# Promovimi dhe Website GreenAL





## Fattorizzimi i punës dhe kontributit të OSHC-ve



# Faktorizimi i punës dhe kontributit të OSHC-ve



**Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile - Instrumenti kryesor për dialog dhe konsultim mes qeverisë së Shqipërisë dhe shoqërisë civile është KKShC. Ligji "Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" (Nr. 119/2015).**

- Krijimin e KKSHC për të garantuar bashkëpunimin institucional me OSHC në RSH, në favor të zgjerimit të demokracisë, forcimit të mirëqeverisjes, rritjes së transparencës në vendimmarrjen publike nëpërmjet përfshirjes më të mirë të SHC në këtë proces.
- Zhvillimin e bashkëpunimit institucional me OSHC për hartimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare dhe Udhërrëfyesit të Qeverisë Shqiptare për krijimin e një kuadri mundësues për sektorin e ShC dhe marrëdhënieve ndërsektoriale të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe OSHC për zhvillimin e filantropisë dhe kapitalit social.
- Përcaktimin e parimeve dhe procedurave sipas të cilave drejtohet dhe zhvillohet procesi i dialogut dhe konsultimit në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile



# Faktorizimi i punës dhe kontributit të OSHC-ve

**Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian**, Ligj nr. 15/2015 “Për rolin e kuvendit në procesin e integrimit të republikës së shqipërisë në bashkimin evropian”

Këshilli Kombëtar i Integrit Evropian (KKIE) është krijuar si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që ngrihet pranë Kuvendit.

KKIE ka **qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës** ndërmjet forcave politike, **institucioneve publikë dhe shoqërisë civile**, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integrimit.

Sigurimi i diskutimit të vazhdueshëm për politikat e integrimit evropian, të zbatuara nga institucionet shtetërore, me shoqërinë civile dhe me aktorë të tjerë të interesuar.



## Ndryshimet klimatike

- Energji, efienca, energji e rinovueshme, varfëria energjitike;
- Transporti, emetimet, monitorimi i ofrimit të shërbimit;
- Impakti i ndryshimeve klimatike në burimet ujore;
- Impakti i ndryshimeve klimatike në bujqësi dhe siguria ushqimore;
- Vulnerabiliteti i komuniteteve me fokus grupet vulnerabël dhe gratë;
- Nxehësia në kontekstin urban/rural dhe impakti në shëndetin e qytetarëve;
- Planifikimi urban dhe ndërtimi, rinovimi banesave, zgjerimi sipërfaqeve të padepërtueshme.
- Vlerësimi i impaktit të ndryshimeve klimatike në ekonomi;
- Impakti nga dhe kontributi i pyjeve në ndryshimet klimatike;
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit dhe grupeve të interesit lidhur me impaktin, nxitësit, pasojat dhe kostot e ndryshimeve klimatike;
- Reduktimi i Riskut nga Fatkeqësitë, ekspozimi i komuniteteve dhe roli i tyre në reduktimin e riskut;
- Aplikimi i zgjedhjeve të bazuara në natyrë në kontekstin urban dhe atë natyror;
- Rishikimi i legjislacionit aktual, strategji, plane, rregullore;
- Rritja e kapaciteteve të OSHC dhe institucioneve në nivel lokal, rajonal e kombëtar lidhur me shkaqet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike.

## Ndotja

- Monitorimi i Cilësisë së ajrit në zonat urbane, industriale dhe pika të nxehta;
- Monitorimi i niveli i zhurmave në zonat urbane dhe ato industriale dhe pika të nxehta;
- Ndotja e tokës në zonat urbane dhe ato rurale me fokus metalet e rënda, nitrate, pesticide, hidrokarburet;
- Ndotja e burimeve ujore: **Uji për njerëzit**, që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve; **Uji për ushqimin**, që përfshin përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit; **Uji për mjedisin**, që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat dhe pyjet;
- Gjelberimi urban dhe shërbimet e ekosistemit;
- Mbetjet, ekonomia qarkulluese, ndotja detare; kompostimi në komunitet dhe shkallë;
- Ndotja nga hidrokarburet dhe impakti në shëndetin e komuniteteve dhe natyrë;
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit dhe grupeve të interesit: trajnime të OSHC-ve institucioneve; edukimi mjedisor në kurikula; nxitja e praktikave të përfshirjes së komunitetit në monitorim;
- Rishikimi i legjislacionit aktual, strategji, plane, rregullore;
- Kërkimi dhe inovacioni.

# Çështje mjedisore me interes GreenAL



## Natyra

- Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit: Permirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura, parqet dhe rezervatet kombëtare duke përfshirë edhe ato detare;
- Restaurimi i ekosistemit: pyllëzime dhe ripyllëzime; restaurimi i ligatinave për të përmirësuar cilësinë e ujit biodiversitetin dhe reduktuar përmbytjet;
- Ekosistemet bregdetare dhe detare, mbrojtja dhe promovimi;
- Menaxhimi i qendrueshëm i tokës: parandalimi i erozionit dhe rëshqitjeve;
- Menaxhimi i baseneve ujore, përfshirë zonat riparjane (buferike);
- Mbrojtja e ligatinave si element për ruajtjen e cilësisë së ujit dhe biodiversitetit;
- Identifikimi dhe ngritja e rrjetit “Natyra 2000”;
- Menaxhimi i qendrueshëm i pyjeve dhe promovimi i praktikave të mira për pëfshirjen e komunitetit;
- Krimi mjedisor, gjuetia e paligjshme, prerja e pyjeve, zjarret në pyje dhe zona të mbrojtura;
- Praktika të mira për parandalimin e zjarreve në pyje dhe zona të mbrojtura;
- Monitorimi i zhvillimit urban në zona e mbrojtura.
- Monitorimi i shfrytëzimit të burimeve natyrore.
- Rishikimi i legjislacionit aktual, strategji, plane, rregullore;
- Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit dhe grupeve të interesit: trajnime të OSHC-ve institucioneve; edukimi mjedisor në kurikula; nxitja e praktikave të përfshirjes së komunitetit në monitorim;
- Monitorimit dhe vlerësimit të statusit për habitatet dhe speciet me rëndësi kombëtare/ndërkombëtare.

# Çështje mjedisore të ngritura nga institucionet



- Mungesa e planeve të cilësisë së ajrit dhe zhurmës;
- Mungesa e kapaciteteve dhe mjeteve për monitorimin e cilësisë së ajrit dhe zhurmave;
- Menaxhimi i mbetjeve, infrastruktura, kompostimi, ekonomia qarkulluese ndërgjegjësimi;
- Ndotja nga plastika me fokus burimet ujore dhe detin;
- Menaxhimi i pyjeve, hartimi i planeve, monitorimi, masa për parandalimin e zjarreve, përfshirja e komunitetit në mirëmbajtje;
- Ndotja në burimet ujore, tokë dhe ajër nga industria e përpunimit të hidrokarbureve dhe mineraleve;
- Erozioni dhe rëshkitjet në disa territore të bashkive;
- Studim mbi ndalimin e inpaktit të erozionit detar
- Mungesa e infrastrukturës për grumbullimin transportin dhe trajtimin e ujrave të ndotur urban;
- Vlerësimi i shërbimeve të ekosistemit në zonën urbane dhe atë natyrore;
- Ndotja e tokës bujqësore nga përdorimi i ushqyesve dhe pesticideve në proceset bujqësore;
- Përfshirja e universiteteve në procese monitorimi, ndërgjegjësimi, dhe kapacitimi;
- Vlerësimi i impaktit në mjedis dhe shëndet të ish zonave industrial;
- Nevoja për trajnime në shkrimin e projekt propozimeve dhe në çështjet mjedisore;
- Ndërgjegjesimi i komunitetit dhe grupeve të interesit lidhet me çështjet kryesore mjedisore.

# Faleminderit!